

PROCESVERBAL

**nga vazhdimi i seancës së 27-të e Këshillit të Agjencisë së Shërbimeve
Mediatike Audio dhe Audiovizuele
të mbajtur me datë 28.07.2026**

Anëtarët e Këshillit të Agjencisë të pranishëm nëpërmjet lidhjes video-konferencë: mr. Sasho Stefanovski, mr. Zirjeta Jajaga, Afrona Vërzivolli, Cvetanka Minovska, Petar Xhurovski, Viktor Pavlovski.

Anëtarët në mungesë të Këshillit të Agjencisë: mr. Gordana Majnova (pushim vjetor).

Në seancë nëpërmjet lidhjes video-konferencë ishte i pranishëm dhe dr. Zoran Trajčevski, drejtori i Agjencisë së Shërbimeve Mediatike Audio dhe Audiovizuele.

Të punësuar nga shërbimi profesional të pranishëm nëpërmjet lidhjes video-konferencë: /

Të pranshmit e tjerë: /

Kryetari i Këshillit, mr. Sasho Stefanovski e hapi vazhdimin e seancës së 27-të të Këshillit. Seanca filloi në ora 13:00 dhe u mbajt nëpërmjet lidhjes video-konferencë.

RENDI I DITËS

1. Miratimi i Propozim-procesverbalit nga seanca e 7-të publike e Këshillit të Agjencisë së Shërbimeve Mediatike Audio dhe Audiovizuele e mbajtur me datë 16.07.2026.
2. Miratimi i Propozim-procesverbalit nga vazhdimi i seancës së 25-të e Këshillit të Agjencisë së Shërbimeve Mediatike Audio dhe Audiovizuele e mbajtur me datë 16.07.2026.
3. Miratimi i Propozim-procesverbalit nga seanca e 26-të e Këshillit të Agjencisë së Shërbimeve Mediatike Audio dhe Audiovizuele e mbajtur me datë 16.07.2026.
4. Shqyrtimi i raporteve tremujore mbi punën e Agjencisë së Shërbimeve Mediatike Audio dhe Audiovizuele për periudhën nga 1 prill deri më 30 qershor 2026.
5. Propozim-vendim për vazhdimin e lejes për transmetim televiziv të ShTR Televizioni Makpetrol ShPKNJ P Shkup.
6. Propozim-aktvendim për fshirje nga regjistri i radiodifuzerëve të ShTR Protel ShPKNJ P Probishtip.
7. Propozim-vendim për ndryshimin e strukturës pronësore të RA Nasha TV ShPKNJ P Shkup.
8. Propozim-vendim për ndryshimin e strukturës pronësore të ShTR RFM SHPKNJ P Shkup.

9. Propozim për shqiptimin e masës paralajmërim publik ndaj operatorit Viva net ShPK Berovë, për shkelje të nenit 141 të LShMAAV-së.

10. Propozim për miratimin e mjete financiare për rinovimin e 4 (katër) aksesëve të përdoruesve në bazën elektronike të të dhënave të rregulloreve në “Gazetë Zyrtare të Republikës së Maqedonisë së Veriut”.

11. Propozim për dhënien e miratimit për marrjen e vendimit për furnizim të shërbimit – mirëmbajtja e apareteve të kafes për nevojat e Agjencisë.

12. Propozim për dhënien e miratimit për zbatimin e procedurës për furnizim publik të shërbimit: hulumtim – analizë e çështjeve gjinore dhe mënyra e prezantimit dhe përfaqësimit të grave dhe burrave në programet e transmetuesve në vitin 2026.

13. Propozim për dhënien e miratimit për zbatimin e procedurës për furnizim publik të shërbimit: Çertifikata digjitale.

14. Të ndyshme.

Pikaa 7 dhe 8

Kryetari i Këshillit, mr. Sasho Stefanovski, informoi se, pas konsultimeve të kryera në lidhje me pikat 7 dhe 8 nga rendi i ditës, propozoi që Këshilli të anulojë votimin e kryer më parë për këto pika dhe të mundësojë afat shtesë për veprimin ndaj lëndëve. Ai shpjegoi se shërbimeve profesionale të Agjencisë duhet t’u mundësohet kohë shtesë për të kontrolluar strukturat pronësore të personave, lidhur me ndryshimet e propozuara në strukturën pronësore të Nasha TV dhe Radio RFM.

Këshilltarja Zirjeta Jajaga, kërkoi sqarime në lidhje me afatin maksimal për vazhdimin e procedurës, duke marrë parasysh se sipas kuptimit të saj afati është 90 ditë.

Drejtori i Agjencisë, dr. Zoran Trajčevski, sqaroi se afati bazë për veprim është 30 (tridhjetë) ditë, dhe i njëjti mund të vazhdohet në afat shtesë prej 30 (tridhjetë) ditësh, përkatësisht afati në tërësi për veprim mund të jetë në maksimum 60 (gjashtëdhjetë) ditë.

Votimi për pikën 7

Këshilli i Agjencisë me 4 (katër) vota „pro“ dhe dy abstenime nga Zirjeta Jajaga dhe Afrona Vërzivoli, miratoi Konkluzën në pajtim me nenin 41, paragrafi (4) të Ligjit të Shërbimeve Mediatike Audio dhe Audiovizuele për vazhdimin e afatit për miratim mbi ndryshimin e kërkuar të strukturës pronësore të Shoqërisë Radiodifuzive Nasha TV ShPKNjP Shkup, të përcaktuar në nenin 41, paragrafi (3) për kohë shtesë prej 30 (tridhjetë) ditësh. Vazhdimi i afatit është i nevojshëm për përcaktimin në tërësi të të gjitha fakteve dhe rrethanave relevante për lëndën dhe për të siguruar të gjitha informacionet e nevojshme për veprim ligjor, të duhur dhe objektiv në pajtim me rregullat ligjore në fuqi.

Spektori për planifikim startegjik dhe të drejtat e autorit duhet të njoftojë me shkrim transmetuesin për vazhdimin e afatit.

Votimi për pikën 8

Këshilli i Agjencisë me 4 (katër) vota „pro“ dhe dy abstenime nga Zirjeta Jajaga dhe Afrona Vërzivolli, miratoi Konkluzë në pajtim me nenin 41, paragrafi (4) të Ligjit të Shërbimeve Mediatike Audio dhe Audiovizuale për vazhdimin e afatit për miratim mbi ndryshimin e kërkuar të strukturës pronësore të Shoqërisë Tregtare Radiodifuzive RFM ShPKNJ P Shkup, të përcaktuar në nenin 41, paragrafi (3) për kohë shtesë prej 30 (tridhjetë) ditësh. Vazhdimi i afatit është i nevojshëm për përcaktimin në tërësi të të gjitha fakteve dhe rrethanave relevante për lëndën dhe për të siguruar të gjitha informacionet e nevojshme për veprim ligjor, të duhur dhe objektiv në pajtim me rregullat ligjore në fuqi.

Spektori për planifikim strategjik dhe të drejtat e autorit duhet të njoftojë me shkrim transmetuesin për vazhdimin e afatit.

**Agjencia e Shërbimeve Mediatike
Audio dhe Audiovizuale
Kryetari i Këshillit,
mr. Sasho Stefanovski**

Përktheu: Antoneta Shabani